**S T A T U T I**
**I**
**SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**« Cloudnet » SH.P.K.**

## KREU I PARE
## Pjesa e pergjithshme

### Neni 1

Shoqeria tregtare **«Cloudnet » SH.P.K.** formohet nga ortaket themelues:

1. **Znj. Suada Tila**, e bija e Mustafa, lindur me 10.07.1991 ne Elbasan dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit ID me numer 033644985.
**2. Z. Xhulian Xhafa** , i biri Etem, lindur me 23.06.1992, ne Lushnje dhe banues ne Tirane , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar , mbajtes i leternjoftimit ID me numer 034248076.
Vendos sa vijon:

Deklaron se me vullnet te lire, te plote dhe ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 ``Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare`` dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 ``Per Qendren Kombetare te Regjistrimit``, nepermjet Aktit te Themelimit ,sot ne date 17.02.2021 kane vendosur te japin kontributin e tyre sipas percaktimeve qe parashikohen ne kete statut per arritjen e objektivave ekonomike duke destinuar ne nje sipermarrje pasuri te tyre me qellim qe te ndajne fitimin ose qe te mund te perfitojne nga te ardhurat qe rrjedhin prej saj.

## Forma,emertimi,selia,kohezgjatja

### Neni 2

1.Shoqeria tregtare eshte e organizuar si shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar dhe do te mbaje emertimin : ``Cloudnet`` SHPK .
2.Ortaket e kesaj shoqerie marrin persiper te paguajne pjesen qe u takon nga humbjet e aktivitetit tregtar ne kete shoqeri.
3.Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare mund te ruhet i njejti emertim me kusht qe personi juridic te shtoje ne kete emertim nje shenim I cili ka te bej me transferimin.

**Neni 3**

Shoqeria tregtare ``Cloudnet ``SHPK do te permbushe objektin e veprimtarise se vet me nje afat te pacaktuar kohe.Ky afat mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas rregullave te parashikuara ne kete statut dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 4**

1.Shoqeria tregtare ``Cloudnet `` SHPK ka seline qendrore ne territorin e Republikes se Shqiperise ne qytetin e Tiranes ne adresen: Rruga e Kavajes, qendra ``Condor Center `` hyrja 1,zk 8220 ,vol 19 ,nr.pasurie 7/244-N42 .
2. Shoqeria tregtare ``Cloudnet ``SHPK pas perfitimit te personalitetit juridik mund te marre masa per te patur nje adrese interneti si dhe nje poste elektronike per komunikim. Keto adresa do te jene te vlefshme per te tretet vetem pasi ti jene njoftuar Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me piken 2 te nenit 69 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare`` .
3.Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare ,filiale,zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jasht vendit.
4.Ajo mund te jete pjesemarrese ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
5.Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe jasht saj ne perputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendren e vet.
6.Shoqeria do te kete vulen dhe logon e saj.Ajo do ti perdore ato vetem pas fitimit te personalitetit juridik ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi.Me Vendim te Asamblese se Pergjithshme ,vula e shoqerise dhe logoja mund ti raportohen Qendres Kombetare te Regjistrimit.

**Neni 5**

1.Shoqeria tregtare ``Cloudnet `` SHPK fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 `` Per Qendres Kombetare te Regjistrimit``.
2.Ndryshimet e shoqerise duke perfshire edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

**Neni 6**

Shoqeria tregtare ``Cloudnet `` SHPK ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Import – Eksport ,tregtim e transport me shumice dhe pakice te pajisjeve te ndryshme elektrike dhe elektronike dhe mekanike;
- Hapje pikash servisi per riparime te ndryshme per pajisjet elektrike dhe elektronike dhe mekanike,transport pjesesh kembimi etj,

. Import – Eksport ,tregtim e transport me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem ,industriale,konfeksione te ndryshme,veshje per burra dhe gra duke hyre ne marredhenie me te tretet;

. Shoqeria mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushen e konfeksioneve;

.Tregtim te lendeve te para ,te materialeve te cdo lloji, Import – Eksport ,tregtim e transport me shumice e pakice te lendeve te para per permbushjene e veprimtarise se shoqerise.

.Shoqeria mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar,mund te veje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme ,ta hipotekoje kete pasuri ne regjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj:

.Mund te hyj ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushen e konfeksioneve;

. Import – Eksport,prodhim,transport e tregtim per te tretet me materialin e vet ose te porositesit:

**Neni 7**

Shoqeria tregtare ``Cloudnet `` SHPK nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.

**(Kapitali)**
**Neni 8**

1.Shoqeria tregtare ``Cloudnet `` SHPK do te filloje veprimtarine e saj me nje kapital themeltar prej 100 000 (njeqind mije ) leke, e cila zoterohet ne pjese te barabarta nga dy ortaket e saj.

2.Pjesemarrja e ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte:

| | | | |
|---|---|---|---|
| a) Znj.Suada TILA | 50 000 Leke | perkatesisht | 50% te kuotave |
| b) Z.Xhulian XHAFA | 50 000 Leke | perkatesisht | 50%te kuotave |

3.Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta me vlere 1 000 Leke secila.Vlera nominale e pjeseve (kuotave) nuk mund te jete me e vogel se 1 000 Leke.Ne baze te kesaj ndarjeje ortaket e kesaj shoqerie zoterojne secili nga 50 (pesedhjete) kuota me vleren 1 000 Leke secila kuote.

### Neni 9

Ne baze te pjesemarrjes se kapitalit themeltar ne shoqeri,fitimi i shperndahet ortakeve te shoqerise ne raport me kuotat e zoteruara.Keto fitime u shperndahen ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividentit:

a)5% per fondin rezerve,deri sa ky fond te arrije 1/5 e kapitalit themeltar:
b)pjesa tjeter i shperndahet ortakeve ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar.

### Neni 10

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.Krijimi i nje fondi te tille ,behet gjithmone me vendim te Asamblese se Ortakeve.

### Neni 11

1.Perberja e kapitalit te shoqerise ,fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi i cdo fondi te vecante percaktohen nga organi perkates sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2.Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi cdo operacion financiar i saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

### Neni 12

1.Shoqeria tregtare ``Cloudnet `` SHPK eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2.Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3.Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar , asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

### Neni 13

1.Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2.Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim nga Asambleja e Pergjithshme.
3.Llogarite vjetore,inventari,raportet dhe operacionet e vitit financiar ,raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 14**

1.Kuotat e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trasheqimie.Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermejt pasardhesve dhe paraardhesve.
2.Personi qe e fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes se ortakut,gezon te drejtat e titullarit te cilat do ti kishte ai.Por ama me perjashtim te faktit qe perpara se te realizohet ky regjistrim i kuotes duhet patjeter te behet dorezimi perkates.

**Neni 15**

1.Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

**Neni 16**

1.Ne rast mospranimi pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin nga Asambleja e Ortakeve.
2.Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim,prane nje noteri dhe i njoftohet shoqerise.
3.Transferimi i tyre ,merr vlere pas regjistrimit te kalimit te kuotave prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

**Neni 17**

1.Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne natyre apo zvogelimi i tij behet me miratimin e Asamblese se Pergjithshme mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar dhe me kerkesen qofte edhe te administratorit te shoqerise.

**Neni 18**

1.Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe rritja e kapitalit te behet dhe me rezervat dhe me fitimet e pashperndara te shoqerise,gjendje te cilat figurojne deri ne daten 31 dhjetor te vitit/viteve financiar/financiare paraardhes/paraardhese.Kjo gje behet vetem pasi Asambleja e Pergjithshme ,me vendim te kete miratuar llogarite

vjetore te shoqerise per vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhes/paraardhese.
2.Pas marrjes se nje vendimi te tille,Asambleja e Pergjithshme cakton nje ekspert kontabel te autorizuar per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise ,gjendje te dates 31 dhjetor te vitit paraardhes.
3.Pas prezantimit te aktit te vleresimit nga eksperti kontabel i autorizuar ,Asambleja e Pergjithshme e shoqerise,me nje vendim tjeter,percakton menyren e rritjes se kapitalit themeltar te shoqerise.
4.Pas marrjes se vendimit te dyte nga Asambleja e Pergjithshme,e gjithe procedura e ndjekur ne zbatim te ketij neni do te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit sipas parashikimeve te Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 ``Per Qendren Kombetare te Regjistrimit``.

## KREU I DYTE
## Ortakeria

### Neni 19

Ortakeria per shoqerine tregtare ``Clodnet`` SHPK krijohet dhe mbeshtetet ne Aktin e Themelimit te kesaj shoqerie dhe ne ligj.

### Neni 20

Shoqeria tregtare ``Cloudnet `` SHPK ,ka vetem dy ortake ,te drejtat dhe detyrimet e te cileve percaktohen ne kete statut dhe ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare`` .

### Neni 21

Ortaket e shoqerise tregtare ``Clodnet`` SHPK gezojne te gjithe te drejtat dhe marrin persiper detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise ,ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e shoqerise.

### Neni 22

Te drejtat dhe detyrimet e ortakut jane si me poshte:

- Te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme
- Te paraqese pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise.
- Te informohet mbi permbajtjen e raportit te administrimit,inventaret e llogarite vjetore,tekstet e vendimeve te propozuara,e raportin e ekspertit kontabel.
- Te perfitoje nga fitimi i shoqerise

- Te kerkoje prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara

## KREU I TRETE
## Organizimi i shoqerise

### Neni 23

Shoqeria tregtare ``Cloudnet`` SHPK ka si struktura drejtuese :

- Asamblene e Pergjithshme
- Administratorin

### Neni 24

1. Asambleja e Pergjithshme ,si organ vendimmarres per shoqerine, eshte pergjegjes per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
b) ndryshimet e statutit
c) emerimin e shkarkimin e administratorit
d) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat `c` dhe `d` te kesaj pike
f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret ,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
i) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre
j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit
k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Ortakut te Vetem
m) ceshtje te tjera te percaktuara nga ligji apo statuti

2. Asambleja e Ortakeve merr vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat `g` dhe `h` te pikes `1` te ketij neni,pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.

3.Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme do te regjistrohen ne nje regjister te vendimeve,te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve percaktohen me vendim te ortakut te vetem. Asambleja e Pergjithshme,me vendim,mund te ngarkoje dhe nje person fizik per mirembajtjen e regjistrit te mbledhjeve.

4. Nga ana e Asamblese se Pergjithshme merren te gjitha masat perkatese per regjistrimin e vendimeve te saj prane organeve perkatese shteterore dhe sidomos ne vecanti,vendimet per:
a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise

b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
c) investime
d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
e) vendimet e marra ne zbatim te nenit 18 te ketij statuti

5.Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme.Shoqeria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmerine te tretit ,qe ka fituar te drejta ne mirebesim.Pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

**Neni 25**

1. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme zhvillohet ne rastet e percaktuara nga Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare`` , nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise . Mbledhja e ortakut te vetem thirret dhe zhvillohet te pakten nje here ne vit.

2. Asambleja e Pergjithshme thirret nga te pakten njeri prej ortakeve,administratori apo dhe nga eksperti kontabel i autorizuar kur ka nevoje per diskutime per ceshtjet ekonomike qe lidhen me shoqerine.

3. Asambleja e Pergjithshme thirret nese ,sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare , rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitete e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.

4. Asambleja e Pergjithshme mblidhet dhe sipas parashikimeve te tjera te percaktuara ne nenin 82 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare`` .

5.Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga personat e tjere te parashikuar nga pika 2 eketij neni jo me vone se 7 (shtate ) dite perpara dates se parashikuar ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme .Menyra e thirrjes se Asamblese se Pergjithshme behet sipas percaktimeve perkatese te parashikuara ne nenin 83 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare``.

**Neni 26**

1. Administrimi i shoqerise `Cloudnet` SHPK kryhet nga Administratori ,i cili emerohet nga Asambleja e Pergjithshme .Administratori mund te jete person dhe person fizik jashte shoqerise.

2. Administrator i shoqerise i emeruar nga Asambleja e Pergjithshme eshte Z. Xhulian XHAFA.

3.Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:
a) kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme
b) perfaqesoje shoqerine tregtare
c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
d) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve , i paraqet keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
e) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
f) kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 ``Per Qendren Kombetare te Regjistrimit``.
g) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare
h) perfaqesoje shoqerine ne marredhenie me te tretet
i) kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut

**Neni 27**

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo per faje te kryera gjate administratitmit te shoqerise.

**Neni 28**

Te gjithe personat qe do te punesohet prane kesaj shoqerie , punesimi i tyre do te behet mbi bazen e kontrates individuale ose kolektive, sipas rastit, ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.

**KREU I KATERT**
**Bashkimi dhe ndarja e shoqerise**

**Neni 29**

1.Shoqeria ``Cloudnet`` SHPK me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ato themelojne qe ushtron te njejtin aktivitet.
2. Gjithashtu shoqeria ``Cloudnet`` SHPK me ane te ndarjes mund ti kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

3. Ne rast se operacioni perfshin krijimin e shoqerive te reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave qe i perkasin shoqerise qe do te krijohet.
4. Transferimi i plote i aktivit te shoqerise apo kontributi ne aktiv te nje shoqerie tjeter ,vecanerisht me ate te procesit te bashkimit te autorizohet nga Asambleja e Pergjithshme.

## KREU I PESTE
## Prishja dhe likuidimi i shoqerisse

### Neni 30
### PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

1. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkaku, si ne rast falimentimi,privim te te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar,forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaku ose Asambleja e Pergjithshme.

2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj.Per kryerjen e ketij procesi ortaku i vetem emeron nje ose disa likuiditore ,te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise , mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Shoqeria prishet ne keto raste:

- Kur nuk mund te permbushet objekti per te cilen eshte krijuar shoqeria
- Me vullnetin e Ortakut te vetem
- Me vendim te gjykates
- Shkaqe te tjera te parashikuara ne ligj

### Neni 31

1. Likujdimi i shoqerise tregtare ``Cloudnet`` SHPK vendoset nga Asambleja e Pergjithshme kur prishet shoqeria.
2. Likuidimi i shoqerise do te behet duke zgjedhur proceduren e zakonshme te parashikuar ne nenet 192-203 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare`` .

### Neni 32

1. Ne qofte se Asambleja e Pergjithshme , per mbylljen e parashikuar ,nuk mund te marre vendim ose nuk pranon te miratoje llogarite e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kerkesen e likuiduesit ose cdo person te interesuar.

2. Nese nuk eshte proceduar si me siper Gjykata me miratimin e Asamblese se Pergjithshme zbaton dispozitat ligjore dhe nese miratimi nuk eshte dhene deri ne seancen e pare gjyqesore ky miratim , propozohet i mireqene.

## Neni 33

Ne fund te procesit te likuidimit thirret Asambleja e Pergjithshme per te vendosur ne lidhje me bilancin financiar perfundimtar.

## DISPOZITA TE FUNDIT

## Neni 34

1. Te gjitha mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.
2. Ne rastet kur ato nuk mund te zgjidhen ne rruge administrative atehere kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

## Neni 35

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te aplikohet Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 ``Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare`` si dhe Legjislacioni shqiptar ne fuqi.

## Neni 36

Ky statut hartohet ne 4 ( kater ) kopje origjinale me te njejten vlere ligjore.Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**THEMELUESIT**

**Z. Xhulian XHAFA** Xhulian Xhafa

**Znj. Suada TILA** Suada Tila